

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI - TEKNOLOGJI USHQIMORE ME BIOTEKNOLOGJI

PROGRAMI - SHKENCA E USHQIMIT



PUNIM DIPLOME

(Niveli Master)

Mentor:

Prof.Asst. Dr. Rreze Gecaj

Kandidati/ja:

BSc. Dhurata Axhami

Prishtinë, 2023

ABSTRAKTI

Ky hulumtim ka për qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale rreth sistemeve të biosigurisë në fermat vendore, duke analizuar zbatimin e masave të biosigurisë në fermat blegtorale dhe rolin e tyre në sigurinë dhe cilësinë ushqimore. Kjo iniciativë u ndërmor për të studiuar frekuencën e përdorimit të masave të ndryshme të biosigurisë në fermat e gjedheve, deleve dhe dhive në Kosovë. Synimi kryesor i këtij punimi është që të sjellë të dhëna të verifikuara lidhur me masat e biosigurisë të cilat zbatohen nga fermerët në ferma të ndryshme në vendin tonë, se cilat masa të biosigurisë janë në përdorim dhe se cilat masa nevojiten të aplikohen për planifikimin e emergjencës së sëmundjeve në zhvillim ose kur luftohen sëmundjet endemike. Njohuritë për nivelin e biosigurisë së një ferme janë gjithashtu të nevojshme për të vlerësuar nëse dhe ku nevojitet përmirësim. Informacioni në lidhje me nivelet e biosigurisë do të jetë i dobishëm për vlerësimet e ardhshme të rrezikut të sëmundjeve të kafshëve.

Siguria e ushqimit është një shqetësim real social dhe një çështje globale që duhet trajtuar. Siguria e ushqimit është aktualisht një nga çështjet më të rëndësishme me të cilën përballen konsumatorët, prodhuesit dhe shpërndarësit. Rritja e incidencës së sëmundjeve zoonotike që vijnë nga ushqimi në të gjithë botën është një rrezik për sigurinë e ushqimit dhe shëndetin publik. Biosiguria është një qasje strategjike dhe e integruar për të analizuar dhe menaxhuar rreziqet përkatëse për jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve si dhe rreziqet që lidhen me mjedisin.

Për të realizuar këtë punim është përdorur pyetësi si metodologji studimi. Pyetjet të cilat janë parashtruar kanë qenë kryesisht të formës së mbyllur, me përjashtim të vetëm një pyetje në formë të hapur. Pyetësit i janë dorëzuar drejtpërdrejt fermerëve apo personave përgjegjës në fermë, si dhe është vëzhguar gjendja aktuale në ferma. Pjesëmarrësit u informuan se të gjitha të dhënat e regjistruara do të përpunohen dhe analizohen në mënyrë anonime. Mbledhja e të dhënave është bërë në disa qytete të ndryshme të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të zgjëruar të të dhënave dhe të shtrirë në nivel të vendit. Të gjitha të dhënat e fituara dhe të kategorizuara janë futur në një bazë të të dhënave për tu analizuar më tutje përmes programit Microsoft Excel dhe më pas rezultatet janë paraqitur përmes shablloneve të grafikëve në Excel.

Në bazë të rezultateve të fituara përmes pyetësorëve të realizuar në gjithsej 36 ferma në tri regjione të Kosovës, në regjionin e Ferizajit, atë të Prishtinës dhe në atë të Pejës, ku prej të

cilave 86% kanë qenë ferma të gjedheve, 8% ferma të deleve dhe 6% ferma të dhive, përfundojmë që nuk demonstrohet një integrim i përgjithshëm i lartë i masave të biosigurisë nga fermerët vendor në praktikën e tyre të menaxhimit dhe se niveli i biosigurisë në vendin tonë është mjaft i ulët. Nga të gjitha fermat e vizituara, 67% e tyre operonin me sistem të kombinuar, 28% e tyre operonin me sistem të mbyllur dhe vetëm 5% e tyre operonin me sistem të hapur. Rreth 81% e pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim janë shprehur që nuk kanë njohuri të mjaftueshme rreth termit të biosigurisë, 11% prej tyre deklaruan që janë mesatarisht të njohur me termin biosiguri dhe vetëm 8 % prej tyre deklaruan që janë të njohur me termin. Mungesa e njohurive rreth biosigurisë tregon nivelin e ulët të zbatimit të kontrollit shëndetsor të kafshëve si masë e rëndësishme e biosigurisë. Nga të gjithë të anketuarit, 83% e tyre deklaruan se kafshët i nënshtrohen kontrollit veterinar vetëm kur është nevoja. Masat e biosigurisë të cilat aplikoheshin në përqindje më të ulët ishin: dushi para hyrjes në fermë, veshje dhe këpucë specifike për vizitorët, karantinimi i kafshëve, plani sistematik për kontrollin e insekteve dhe brejtësve. Fermerët pranuan se ekziston hapësira për përmirësimin e nivelit të biosigurisë në fermat e tyre, por shprehën nevojën për informacion praktik dhe mbështetje financiare nga institucionet vendore.

Fjalët kyçe: biosiguria, zoonozat, siguria ushqimore dhe shëndeti publik.